



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 15 Prot.

Tiranë, më datë 15.01.2021

VENDIM
Nr. 5, datë 15.01.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.01.2021,

VENDOSI:

1. Shtyrje vendimmarrje për propozimin “Koncept për sondazhe arkeologjike për projektin e zhvillimit “Agroturizëm Bota Farms” me zhvillues subjektin Bota Farms Sh.a., Bashkia Finiq
 - Të plotësohet me propozimin për konceptin e gërmimit arkeologjik sipas pikes 2 të Vendimit Nr. 363, datë 06.11.2020 dhe në bazë të metodologjisë së sugjeruar nga KKTKM në lidhje me gërmimin që do të kryhet në zonën e sondazhit Nr.14
 - Subjekti aplikues duhet të plotësojë dokumentacionin e depozituar online në lidhje me ndryshimin e njollës së projektit në zonën e sondazhit Nr. 14.
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

